

Në bazë të nenit 55 alinea 1 në Ligjin për organizimin dhe punën e organeve të drejtorisë shtetërore (" Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11), si dhe në bazë të nenit 50 alinea 6 e Ligjit për arsim fillor (" Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 44/1995, 24/1996, 34/1996, 35/1997, 82/1999, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 67/2004, 55/2005, 113/2005, 35/2006, 30/2007, 49/2007, 81/2008, 92/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016, 67/2017 и 64/18) Ministri i Arsimit dhe Shkencës solli program të shkurtuar mësimorë për lëndën mësimore HISTORI për vitin e I-rë të arsimit të mesëm gjimnazor

1. Hyrje

Programi i shkurtuar mësimorë për lëndën mësimore histori bazohet në qëllimet të parapara me programin për lëndën mësimore e cila realizohet në përputhje me planin mësimorë i miratuar për realizim në kushte të zakonshme.

Me programin e shkurtuar përcaktohen tema dhe njësi mësimore të caktuara të cilat duhet të realizohen në 159 ditë mësimore, me ç'rast respektohet fondi javor i orëve l përcaktuar në programin e rregullt, respektivisht lënda mësimore me 2 orë në javë respektivisht 64 orë në vit sipas programit të shkurtuar.

Mësimdhënësi gjatë planifikimit dhe realizimit të njësive mësimore sipas programit të shkurtuar udhëhiqet nga qëllimet, nocionet e caktuara, metodat dhe aktivitetet të përcaktuara në programin e rregullt mësimorë.

Qëllimet e mësimit të historisë në arsimin gjimnazor është që nxënësit të përvetësojnë dituri thelbësore, të sistemuara, të qëndrueshme dhe të verifikuara në mënyrë shkencore për të kaluarën dhe të tanishmen, të kontribuojë për të menduarit kritik dhe të zgjojë vetëdijen historike, në ndërtimin e sistemit të vlerave të sjelljes ndaj popullit dhe shtetit të vet, ndaj popujve dhe shteteve tjera ndaj asaj që përfaqson e arritur civilizuese në botë, si dhe të thellojë interesin për mësimin e mëtejshëm të ngjarjeve dhe proceseve historike.

2. Pasqyra e temave dhe përmbajtjeve mësimore

Tema: Bota dhe Evropa prej vitit 1945-2000 14+7=21

Tema realizohet me 2 orë përmbajtje të reja mësimore dhe me + 1 orë ushtrime dhe përsëritje. Ora mësimore është e planifikuar të zgjasë 30 minuta.

Përmbajtjet

1. Politika në krijimin e botës së pas luftës
2. Sovjetizimi i shteteve të Evropës juglindore
3. Dekolonizimi, neokolonializmi në Botë pas Luftës së dytë botërore

4. Политички, идеолошки и други движења во светот
5. Европски интеграции
6. Zhvillimi i shkences dhe ndryshimet nw kulturw

Tema : Ballkani prej vitit 1945-2000 $8+6=14$

Tema realizohet me 8 orë përmbajtje të reja mësimore dhe me + 6 orë ushtrime dhe përsëritje. Ora mësimore është e planifikuar të zgjasë 30 minuta.

Pwrmbajtjet

1. Refleksionet e politikws ndwrkombwtare nw shtetet ballkanike
2. Funkcionimi l federatws jugosllave dhe shkaqet pwr rwnien e saj
3. Proceset integruese nw shtetet ballkanike pwr inkuadrimin e tyre nw BE dhe arritjet nw shkencw dhe kulturw.

Tema: Maqedonia prej vitit 1945-2000 $15+8=23$

Tema realizohet me 15 orw pwr pwrmbajtje tw reja dhe 8 orw pwr ushtrime dhe pwrswritje. Ora mwsimore wshtw planifikuar nw kohwzgjatje pwr 30 min.

Pwrmbajtjet:

1. Maqedonia nw kuadwr tw Republikws Federative Demokratike tw Jugosllavisw
2. Pozita e maqedonaswve nw pjeswn e egjeut dhe pirinit tw Maqedonisw dhe nw Shqipwri
3. Ndryshimet politiko- ekonomike dhe sociale nw Republikwn e Maqedonisw
4. Lwvizjet migrative nw Republikwn e Maqedonisw
5. Arsimi, shkenca dhe kultura si dhe religjonet nw Maqedoni
6. Maqedonia dhe asociacionet ndwrkombwtare
7. Mwrgimtarwt maqedonas nw Europw dhe nw vendet tejoqeanike

4. Rekomandimet didaktike

Mësimdhënësi mundet t'i zbatojë të gjitha metodat dhe teknikat mësimore të verifikuara në përputhje me qëllimet e definuara. Rekomandohet forcimi i sistemit të metodave problemore dhe krijuese , analitike-interpretative dhe integruese korelative. Mësimdhënësi duhet të iniciojë aktivitete të pavarura të nxënësve, t'i udhëheqë drejt mësimit të menduar receptive dhe të menduarit aktiv dhe ta korigjojë mësimin mekanik- receptive dhe mekanik aktiv.

Gjatë realizimit të programit të shkurtuar në lëndën mësimore në lëndën HISTORI të detyrueshëm për vitin I-rë, mbështetja themelore është programi i rregullt mësimorë (qëllimet konkrete, nocionet, aktivitetet dhe metodat e propozuara). Për realizimin e këtij programi nevojitet planifikimi i integruar respektivisht ndërlidhja e qëllimeve dhe përmbajtjeve si dhe planifikimi i mësimit me ndërlidhjen e mësimnxënies me përvojat e nxënësve. Për realizimin e lëndës mësimore, duhet të zbatohen forma dhe metoda interactive (teknika e mësimit dhe aktivitet). Nga metodat interaktive do zbatohet puna me grupe, diskutime, stuhi mendimesh, analiza e teksteve dhe dokumenteve, studim rasti, por edhe metoda tradicionale: ligjërata të shkurtëra dhe biseda të fokusuara. Rekomandimet për përdorimin e fondit të shkurtuar të orëve janë të dhëna si orientim së bashku me qëllimet dhe temat konkrete/ përmbajtjet shpërdarja e të cilave nuk është e kufizuar por mësimdhënësit i jepet hapsirë që shpërndarjen ta bëjë në përputhje me e ndryshme të cilat paraqiten gjatë realizimit.

Nxënësi duhet vazhdimisht të nxitet dhe motivohet që mësimin ta ndjekë në kontinuitet dhe në mënyrë aktive në përvetësimin e përmbajtjeve të reja , në zhvillimin e mendimit kritik gjatë të mësuarit, në zhvillimin e mundësive dhe aftësive të cilat janë të rëndësishë qenësore për ardhmërinë e jetës së tij.

Me rastin e shpërdarjes rrespektivisht rradhitjes së orëve lejohet kreativiteti dhe elokuenca e mësimdhënësit në realizimin e qëllimeve mësimore.

Kontrollimi i diturive të nxënësve duhet të zbatohet në të gjitha fazat e procesit mësimor, gjatë realizimit të përmbajtjes së re mësimore, gjatë përsëritjes, kontrollimit, sistematizimit, ushtrimeve dhe hulumtimit. Kontrollimi realizohet me teknika të ndryshme për punë me tekste historike, material ilustrues, analizë të pavarur të teksteve historike dhe ilustrimeve, interpretimi i dokumenteve historike dhe vlerësimi i interpretimeve të ndryshme. Gjatë ndjekjes dhe notimit zbatohen mënyra të ndryshme (kontrollimi me gojë dhe me shkrim, teste të diturisë, përpilimi i punëve seminarike, referate, aktivitete të nxënësve në orë mësimore etj.)

Mësimdhënësi do të përdorë mjete mësimore të cilat janë të përcaktuara me programin e rregullt mësimor.

4. Normativi për kuadrin mësimorë

Program i shkurtuar mësimorë e realizon mësimdhënësi në pajtim me normativin për kuadrin mësimorë të përcaktuar në programin e rregullt mësimorë.

Programin e shkurtuar mësimorë për lëndën mësimore HISORI për vitin IV- të në arsimin e mesëm gjimnazor për vitin shkollor 2020/2021 e miratoi

Ministri

Milla Carevska